



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 24 – 518 – 2-2-1/C 846
14 Nr. 129/24
Dt. 27.03.2024

KONTRATË SHËRBIMI/FURNIZIMI
(Kontratë Kornizë 36 mujore)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Azize Krasniqi – u.d. e ZPP-së** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Niti-N** “ emri i biznesit me seli në **Prishtinë**, me ARBK: **810839300**, si **Operatorë Ekonomik**, të cilën e përfaqëson z. **Naim Zymeri**, në tekstin e mëtejme **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMEVE/FURNIZIMEVE**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për shërbime dhe/ ose furnizime, si vijon:
Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Njesisë së Zjarrfikësve , me numër identifikues:

Numri I prokurimit	VU644	2	4	5	1	8	2	2	1
Numri I brendshëm	VU644	2	4	0	0	4	2	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose furnizimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për zjarrfikje për nevoja të Njesisë së zjarrfikësve në Vushtri**, sipas Përshkrimit të Artikujve dhe Çmimeve si dhe / ose Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **VU644-24-004-221**
- 1.2 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon të zbatuar nga data: **26.03.2024** dhe përfundon më së largu deri më dt. **25.03.2027** duke përfshirë edhe këtë datë.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, **tendon të blejë shërbime** në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek **Kryesi I Shërbimeve/Furnizuesi**, duke specifikuar listën me shërbimet dhe sasi të përkatëse që duhen ekzekutuar.
- 1.4 Njësia Kërkuese dhe / ose Menaxheri i Kontratës i A.K. kanë përgjegjësinë e plotë që të kujdesen që sasi të realizuara (shpenzuara) të shërbimeve dhe / ose furnizimeve të porositura.
- 1.5 Në momentin që vlera e shërbimeve të porositura dhe / ose ekzekutuara dhe / ose pranuar arrin vlerën totale indikativë të Kontratës, Kontrata do të ndërpritet menjëherë.
- 1.6 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bënë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

Nenii 2

Kushtet e dërgesës

- 2.1 Të gjitha pjesët që kërkohet-Porositet të zëvendësohen, duhet të zëvendësohen vetëm me pjesë të reja origjinale. Në pamundësi të sigurimit të pjesëve të reja origjinale vlejnë rregullat e saktësuara si në Kushtet e Veçanta të kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit. Po ashtu edhe garancioni i pjesëve të zëvendësuara do të bëhet në pajtim me kushtet e saktësuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- 2.2 Ekzekutimi i Porosive për shërbime dhe / ose furnizime do të përfundohen në kohën më të shkurtër të mundshme, jo më gjatë se 5 ditë , kur janë në dispozicion pjesët e ndërrimit në depo të Kryesit të Shërbimeve/Furnizuesit, ndërsa kur pjesët nuk ndodhen në depon e Kontraktuesit ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose furnizimeve do të bëhet brenda kohës së arsyeshme kohore e cila është përcaktuar nga palët sipas marrëveshjes. Kontraktuesi duhet të bëjë përpjekje maksimale që në depon e tij të ketë rezerva të mjaftueshme të pjesëve rezervë të parashikuara sipas kësaj Kontrate.
- 2.3 Në rastet kur një pjesë e ndërrimit nuk është në depo, Kryesi i Shërbimit/Furnizuesi do të konfirmojë me shkrim tek Autoriteti Kontraktues për datën kur pjesa do të jetë në dispozicion . Në këto raste afati kohor për disponueshmërinë e pjesëve të ndërrimit dhe kryerjes së shërbimit do të jetë afati sa më i shkurtër kohor por jo më gjatë se 30 ditë.
- 2.4 Kontraktuesi - Kryesi i Shërbimeve me rastin e ekzekutimit të shërbimeve dhe / ose Furnizuesi duhet edhe ti testoj pjesët e ndërrimit, për çka duhet që me deklaratë me shkrim të deklaroj se pajisjet dhe / ose pjesët e vendosura sipas Porosisë janë të testuara dhe funksionale sipas standardeve dhe të gatshme për përdorim.
- 2.5 Nëse Kryesi i Shërbimeve/Furnizuesi, me përgjegjësinë e tij, nuk arrin t'i përfundoj ndonjë ose të gjitha shërbimet e porositura brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të përfundimit të shërbimit sipas kësaj Kontrate dhe datës së dërgimit të Porosisë, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa përfunduara - dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë respektivisht të vlerës totale të shërbimeve të papërfunduara.
- 2.6 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Kjo Kontratë Kornizë është e lidhur me çmime për Njësi. Çmimet e njërive të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Shërbimeve dhe / ose furnizimeve si dhe Çmimeve e dorëzuar nga Kryesi i Shërbimeve dhe që është pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 3.2 Çmimet për Njësi të shërbimeve të saktësuara në Ofertën Financiare të përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhen të jenë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kësaj kontrate. Shërbimet dhe / ose furnizimet e porositura dhe të ekzekutuara duhen të jenë të pasqyruara në Porosinë e Vendosur dhe Raportin e Pranimin të Shërbimeve dhe / ose furnizimeve.
- 3.3 Vlera totale indikativë e Kontratës është në shumë prej: 43,147.80€.
- 3.4 Në momentin që vlera e shërbimeve të porositura dhe / ose ekzekutuara dhe / ose pranuar arrin vlerën totale indikativë të Kontratës, Kontrata do të ndërpritet menjëherë.
- 3.5 Pagesat do të bëhen: në pajtim me sasinë e shërbimeve të pranuar dhe të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës dhe të konfirmuar me Raportin me shkrim nga Komisioni i Pranimin të Shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.
- 3.6 Shumat për shërbimet dhe / ose furnizimet e porositura, të ekzekutuara dhe të pranuar do të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

3.7 Kryesi i Shërbimeve dhe / ose furnizimeve siguron Autoritetin Kontraktues se shërbimet e porositura respektivisht pjesët e ndërrimit në pajisje, sipas përshkrimit teknik gjegjësisht Ofertës Financiare, do të jenë cilësore, do të kenë afat të mjaftueshëm dhe / ose konsiderueshëm të garancionit për përdorim ashtu sikurse është saktësuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës, do ti përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare ;
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, e-mail ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin – Kryesin e Shërbimeve.

Për Kontraktuesin : " Niti-N "sh.p.k. – Prishtinë

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Azize Krasniqi	Emri:	Naim Zymeri
Pozita:	u.d. e ZPP-së	Pozita:	menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2024	Data:	27.03.2024
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

~~8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.~~

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasë ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

~~9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.~~

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

~~12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.~~

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

~~*a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*~~

- ~~te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;~~
- ~~- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe~~
 - ~~- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.~~

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuere e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuere e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.


KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	2.3	Data e fillimit të kryerjes se shërbimeve është dita e hyrjes ne fuqi te kontratës.
		Afati për servisimin e automjetit është 20 ditë nga lëshimi i porosisë/urdhër blerjes nga menaxheri i kontratës i autoritetit kontraktues
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	Kualiteti i Shërbimeve Ndhmëse .
		Ofruesi i Shërbimeve do të kryej të gjitha shërbimet me cilësi të lartë dhe të paktën në nivelin që është në përputhje me Manualin e Punëtorisë së prodhuesit dhe me çdo ndryshim siç përcaktohet nga autoriteti kontraktues.
		<p>Aty ku nuk ka udhëzime të veçanta të dhëna nga prodhuesi , Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë një standard në përputhje me nivelet më të larta të industrisë se automobilave , në bazë të testimit të meritave për automjete rrugore me standardet e pranueshme të Kosovës .</p> <p>Pjesa e brendshme e automjeteve duhet të jetë e mbrojtur në çdo kohë duke përdorur mbulesa dhe mbrojtje tjetër për të siguruar që në asnjë mënyrë inventari i brendshëmms të dëmtohet apo të ndotet .</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve nuk do të prekë apo të ngacmoj ndonjë pjesë të një automjeti që nuk kërkon inspektimin si pjesë e ofrimit të ndonjë shërbimi sipas kësaj kontrate . Ofruesi i shërbimeve do të jetë përgjegjës për riparim ose zëvendësim të ndonjë pjesë e cila dëmtohet gjate nje prekjeje të tillë të paautorizuar .</p> <p>Cilësia e pjesëve të rezerve.</p> <p>Duhet te përdoren vetëm pjesë dhe materiale te prodhuesit (GenuineManufacturer'sparts).</p> <p>Në rast se pjesët dhe materialet e automjeteve nga prodhuesi (GenuineManufacturer'sparts)nuk janë në dispozicion, (p.sh. për automjetet e vjetra), ofruesi i shërbimeve duhet të informojë menaxherin e projektit të kontratësi cili mund të bie dakord qe te instalohen pjese standarde ekuivalente si OEM (OriginalEquipmentManufacturer), i cili dakordim duhet te shqyrtohet dhe miratohet nga eksperte teknik te Autoritetit Kontraktuese.</p> <p>Në rast kur automjeti është i pa levizshem për shkakë të defekteve, Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për marrjen e automjetit nga rruga dhe për transportimin e</p>

		<p>automjetit tek lokali i tij dhe pas përfundimit të shërbimeve për dorëzimin e automjetet tek AK. Për transportimin e automjetit nga vendi i prishjes deri në punëtorinë – servisin e kryerësit të shërbimeve operatori ekonomik është i obliguar që transportin në këto raste ta kryej me mjete dhe shpenzime të veta, andaj nuk do të faturohen shpenzimet e transportit.</p> <p>Pjesët e vjetra/te zëvendësuar do të jetë pronë e Autoritetit kontraktues dhe do të duhet të kthehen nga Ofruesi i Shërbimeve tek Autoriteti Kontraktues së bashku me inventarët e pjesëve të zëvendësuar.</p> <p>Të gjitha pjesët që kërkojnë zëvendësim duhet të zëvendësohet vetëm me pjesë origjinale dhe garancioni i pjesës së zëvendësuar duhet të depozitohet tek Autoriteti Kontraktues.</p>	
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e	12.3	Autoriteti Kontraktuese: Zyrtari Kryesor Administrativ, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës do ta caktoj menaxherin e kontratës si dhe komisionin për pranimin e shërbimeve .
Siguria ekzekutimit	e	14.1	<p>Kërkohej siguria e ekzekutimit</p> <p>Siguria e ekzekutimit në vlerë prej 3.600,00 € (Tremijëgjashtë mijë euro) me afat validiteti për periudhën në kohëzgjatje prej 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Siguria e ekzekutimit duhet dorëzuar para nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Dokumenti – Polisë e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë bank apo kompani e Sigurimeve e licensuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit		15.1	<p>Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin Kontraktuese dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të jetë tërësisht përgjegjës për automjetet, gjersa ata janë në objektet e tyre dhe duhet të jetë i siguruar në përputhje me rrethanat. Çdo dëmtim i shkakuar do të korrigjohet nga ofruesi i shërbimeve në shpenzime të veta.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve duhet të sigurojë që i gjithë stafi i tij, i cili vozit Automjetet dhe kryen testin rrugor për automjete, janë të siguruar plotësisht dhe kanë patentë shoferin për kategorinë e automjeteve që vozitin.</p>
Kualiteti i Kontrollit		17.1	<p>Pranimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve:</p> <p>Kontrolli i kualitetit të shërbimeve dhe pranimi i shërbimeve bëhet nga personat përgjegjës të emruar nga Autoriteti Kontraktues.</p> <p>Ofruesi i shërbimeve do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohej ndryshe në kontratë. Ofruesi i shërbimeve do të garantojë që asnjë nga shërbimet- pjesët rezerve të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme dy vite pas pranimi të përkohshëm.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për menjanimin e</p>

		<p>defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:</p> <p>a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Ofruesi i Shërbimeve; ose</p> <p>b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Ofruesi i Shërbimeve gjatë periudhës së garancisë; ose</p> <p>c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet.</p> <p>Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.</p> <p>Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:</p> <p>a) të korigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Ofruesit të Shërbimeve ose nga të dy;ose</p> <p>b) të ndërpresë kontratën.</p> <p>Në raste urgjente, kur ofruesi i shërbimeve nuk mund të gjendet menjëherë, ose, edhe nëse është kontaktuar por nuk është në gjendje të marrë masat e nevojshme, Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit mund të kryejnë punën me shpenzime të Ofruesit të Shërbimeve. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit do të informoj sa më shpejt të jetë e mundur Ofruesin e Shërbimeve për veprimin e marrë.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Bazuar të nenin 20 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës.



Komuna e Vushtrrisë

Shënim: Përshkrimin e çmimeve duhet ta plotësoni me çmimin për njësi në fushat përkatëse, çmimin duhet ta shkruani me dy (2) numra (decimale) pasë presjes dhjetore

Emërtimi i Pjesëve dhe Riparimit		Njesia matëse	Sasia	IVECO, IS55W2EA Kamion, v.prodimit 2014, 2998 cm3, Dizel, Manual	STEYER ROSENBAUER AUTOMJET ZJARRFIKES Kamion v. prodimit 1987 6595cm3 Dizel, Manual	MERCEDES ATEGO 1828 Kamion, v.prodimit 2000, AUTO. ZJARRFIKES Dizel, Manual	MAN Kamion, v.prodimit 1995, Auto. Zjarrfikes 6871 cm3 Dizel, Manual	STEYER KAMION TEKNIK v. prodimit 1984, 6595cm3, Dizel, Manual	HUMBOLD AUTOMJET SHKALLE v. prodimit 1973, 8482 cm3, Dizel, Manual	VOLVO AUTOMJET Kamion Cisternë, v. prodimit 1980, 5861cm3, Dizel, Manual	Totali i servisimit te rreguljte per te gjitha veturat (60 % e pikeve per vleresim)
Kategoria	Sasia e veturave			1	1	1	1	1	1	1	
A	Servisimet e Rregullta			Çmimi për njësi DDP-€	Çmimi për njësi DDP-€	Çmimi për njësi DDP-€	Çmimi për njësi DDP-€	Çmimi për njësi DDP-€	Çmimi për njësi DDP-€	Çmimi për njësi DDP-€	
1	Servisimet e rregullta sipas Planit te servisimeve te rregullta për çdo 10.000 km te kaluara, Të jepet çmimi total për servisimin e rregullt duke ndërruar vetëm: Vaji i motorrit Filteri i Vajit Filteri i Naftës Filteri i Ajrit Filteri i Klimës. Puna e Dorës	Shërbim	1	€ 440.00	€ 430.00	€ 440.00	€ 440.00	€ 430.00	€ 440.00	€ 450.00	3,070.00

Numri i prokurimit VU644-24-518-2-2-1 apo nr. i brendshem Vu644-24-04-221: Titulli : Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në njësin e zjarrfikësve

35	Xhami i pasqyres djaththa	copë	1	€ 50.00	€ 50.00	€ 50.00	€ 50.00	€ 50.00	€ 50.00	€ 50.00	€ 50.00	€ 350.00
36	Pasqyra plastike majta	copë	1	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 560.00
37	Pasqyra plastike djaththa	copë	1	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 80.00	€ 560.00
38	Stopi i mram i djathhtë (brendshme)	copë	1	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 210.00
39	Stopi i mram i majtë (brendshme)	copë	1	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 30.00	€ 210.00
40	Llajsija e deres së mramë ana e majtë	copë	1	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	€ 0.00
TOTALI : D (prej 1-9)												16,480.00

Vërejtje:

Servisi i Rregullt bëhet çdo 10,000.00 km

Në çmimin e pjesës, duhet të përfshirë edhe puna e dorës dhe të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e aplikuara me ligjet në fuqi të Republikën e Kosovës. Të gjitha pjesët e cekura duhet të jenë Originale nga prodhuesi i automjetit dhe Autoriteti Kontraktues do e ketë atë të drejtë që në gjdo kohë të verifikojë origjinalitetin e pjesëve.

Servisimi dhe mirëmbajtja e rregulltë e automjeteve duhet të bëhet sipas kërkesave dhe nevojave të Njesisë së Zjarrfikësve në Vushtrri
 Servisimi i automjetve do të mbikëqyret nga zyrtarët pergjegjes të Njesisë së Zjarrfikësve.

Kategoria	Përshkrimi	Çmimi total në €	Çmimi total i peshuar
A = 60%	Servisimet e Rregullta	4,295.00	2,577.00
B = 20%	Mirëmbajtja dhe pjeset rezerve	187,886.50	37,577.30
C = 5%	Riparimi dhe Ngjyrosje	10,430.00	521.50
D = 15%	Pjesët e karosorisë	16,480.00	2,472.00
Çmimi i Përgjithshem i peshuar (ofertat do të vleresohen në bazë të kësaj vlere). Kjo është vlera e cila do të duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.			43,147.80

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"NITI-N" SH.P.K.

Numri i prokurimit VU644-24-518-2-2-1 apo nr. i brendshem Vu644-24-04-221: Titulli : Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në njësin e zjarrfikësve

EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Naim Zymeri
NËNSHKRIMI:	
DATA:	20.02.2024
VULA:	